



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 maj 2013
Nr. ref.: RK411/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. K104/13

Parashtrues

Zahir Hasani

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, Pkl. nr. 5/2011, të 27 janarit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Zahir Hasani, nga fshati Sharban, komuna e Prishtinës, tash në vuajtje të dënimit me burg, të cilin e përfaqëson i vëllai, z. Sabit Hasani, po ashtu nga fshati Sharban i komunës së Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar i autoritetit publik është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2011, i 27 janarit 2011, për të cilin parashtruesi i kërkesës pohon se e ka pranuar më 20 gusht 2012.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), më 14 janar 2013, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin u refuzua kërkesa e të gjykuarit Zahir Hasani për mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur kundër Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 297/05, të 21 prillit 2010, dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP. nr. 260/2010, të 3 dhjetorit 2010.

Baza juridike

4. Neni 113.7, lidhur me nenin 21.4, të Kushtetutës; neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009; dhe rregulli 54, rregulli 55 e rregulli 56.2, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 janar 2013, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatë. Kërkesa u regjistrua në regjistrin përkatës me Nr. KIo4/13.
6. Më 30 janar 2013, me Vendimin GJ. R. KIo4/13, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese, ndërsa, me Vendimin KSH4/13, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Prof. dr. Enver Hasani e Almiro Rodrigues (anëtarë).
7. Më 13 shkurt 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme përkitazi me regjistrimin e kërkesës.

8. Më 30 prill 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 21 prill 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin P. nr. 297/05, me anë të të cilit, të akuzuarin z. Zahir Hasani, nga fshati Sharban, komuna e Prishtinës, e shpalli fajtor për veprën penale vjedhje pylli, sipas nenit 285, paragrafi 2, i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK), duke e dënuar të akuzuarin me dënimin me burgim në kohëzgjatje 6 (gjashtë) muaj.
10. Kundër këtij aktgjykimi, z. Hasani paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke e mohuar fajësinë e tij dhe duke pretenduar se atij i është mohuar e drejta e paraqitjes së dëshmitarëve që do të dëshmonin në favor të tij.
11. Më 3 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga z. Hasani, nxori Aktgjykimin Ap. nr. 260/10, me të cilin APROVOI pjesërisht ankesën e të akuzuarit Zahir Hasani dhe, me këtë rast, Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 297/05, të 21 prillit 2010, e NDRYSHOI vetëm në pjesën e dënimit, ashtu që Gjykata e Qarkut në Prishtinë, për veprën penale vjedhje pylli, të dënueshme sipas nenit 285 të KPK-së, e shpalli fajtor të akuzuarin Hasani dhe ia shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje 3 muaj, ndërkohë që konstatoi se Gjykata Komunale në Prishtinë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe se ajo ka bërë administrimin e provave të ofruara nga palët në mënyrë të rregullt dhe ligjore.
12. Ndaj këtyre dy aktgjykimeve, tashmë të formës së prerë, z. Hasani paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, me të njëjtat pretendime sikurse në ankesën që kishte parashtruar edhe në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
13. Më 27 janar 2011, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pkl. nr. 5/2011, me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar kundër aktgjykimeve të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 297/2005, të 21 prillit 2010, dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP. nr. 260/2010, të 3 dhjetorit 2010, për arsye se nuk kishte gjetur shkelje substanciale procedurale apo ligjore në aktgjykimet e atakuara nga parashtruesi i kërkesës.

14. Më 10 janar 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë bëri ekzekutimin e dënimit me burg, në përputhje me aktgjykimet e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 297/2005, dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP. nr. 260/2010.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

15. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se, me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, dhe atë: E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm (neni 31).
16. Parashtruesi i kërkesës ka pohuar, gjithashtu, se ka pasur shkelje të dispozitave të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.
18. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike, të përcaktuara me ligj”.

Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ku shprehimisht përcaktohet:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesi i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

19. Për të vërtetuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën brenda afatit katërmuajsh, Gjykata i referohet kohës së pranimit të vendimit të fundit nga parashtruesi i kërkesës, si dhe i referohet datës së paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

20. Nga kopja e formularit standard për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese, konstatohet fakti se parashtuesi i kërkesës ka specifikuar që Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2011, e 27 janarit 2011, e ka pranuar më 20 gusht 2012, ndërsa kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e ka dorëzuar më 14 janar 2013, që do të thotë se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë 24 ditë pas kalimit të afatit katërmujsh, të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
21. Në këto rrethana, parashtuesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, për sa i përket afatit brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, andaj kërkesa duhet të deklarohet si e papranueshme.
22. Gjykata gjithmonë thekson se qëllimi i rregullit për afatin katërmujor është të promovojë sigurinë juridike, të sigurojë se rastet e ngritura për çështje kushtetuese do të shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe për të mbrojtur autoritetet dhe personat e tjerë të interesuar nga të qenit në një situatë të pasigurisë për një periudhë të gjatë kohore (*Shih, mutatis mutandis, PM v Mbretëria e Bashkuar, Kërkesa nr. 6638/03, 19 korrik 2005*).
23. Bazuar në ato që u thanë më sipër, parashtuesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë dhe çështja nuk është parashtuar në Gjykatë në mënyrë ligjore nga parashtuesi i kërkesës, pasi që në bazë të nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese kërkesa është e paafatshme. Andaj,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 24 maj 2013 njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

